

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

“NOVUS ALBANIA” SHPK

KREU I

PËRKUFIZIMET; FORMA; SELIA;

EMRI; KOHËZGJATJA; OBJEKTI

Neni 1 – Emri dhe Përkufizimet

1.1. Në këtë statut (“Statuti”), përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet:

- “**Administrator**” është Administratori i Shoqërisë.
- “**LEK**” është leku shqiptar, monedha zyrtare e Republikës së Shqipërisë.
- “**Shoqëri e Lidhur**” do të thotë, në lidhje me një person, çdo shoqëri holding, shoqëri mëmë, filial, shoqëri e kontrolluar ose çdo filial ose shoqëri tjetër e kontrolluar e një shoqërie holding ose shoqërie mëmë dhe çdo person tjetër që kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me një person të tillë.
- “**Biznes**” ka kuptimin e dhënë në nenin 5.
- “**Ditë Pune**” do të thotë një ditë, e ndryshme nga ditët e fundjavës (e shtunë dhe e dielë) ose ditët e tjera pushim, përgjatë të cilave bankat në Shqipëri dhe në Kosovë janë të hapura për kryerjen normalisht të punës.
- “**Ligji për Shoqëritë Tregtare**” do të thotë ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- “**Person i Lidhur**” në lidhje me një person (“**Personi Përkatës**”), do të thotë:
- (a) bashkëshorti/ja ose partneri/ja civil i Personit Përkatës;
 - (b) çdo person tjetër (qoftë i gjinisë së njëjtë apo të kundërt) me të cilin Personi Përkatës bashkëjeton ose ka bashkëjetuar si partner në një lidhje të qëndrueshme familjare;
 - (c) fëmijët e Personit Përkatës;
 - (d) çdo fëmijë i një personi sipas paragrafit (a), (b) ose (c) (dhe që nuk janë fëmijë të Personit Përkatës);
 - (e) prindërit, vëllezërit dhe motrat e Personit Përkatës dhe fëmijët e këtyre të fundit;
 - (f) prindërit, vëllezërit dhe motrat e një personi sipas paragrafit (a) dhe (b) më sipër;
 - (g) personat e tjerë në zbatim të nenit 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- “**Kontroll**” do të thotë, fuqia e një personi (ose personave që veprojnë së bashku) për të siguruar që punët e një tjetri të kryhen drejtpërdrejt ose tërthorazi në përputhje me dëshirat e atij personi (ose personave që veprojnë së bashku) qoftë me anë të:

- (a) në rastin e një shoqërie, duke qenë mbajtës i të paktën tridhjetë për qind (30%) të kapitalit të emetuar ose të të drejtave të votës në atë shoqëri, ose që ka të drejtë të emërojë ose shkarkojë shumicën e drejtorëve ose ndryshe të kontrollojë votat në mbledhjet e bordit të asaj shoqërie në bazë të çdo kompetence të dhënë nga statuti i shoqërisë, marrëveshja e ortakëve ose ndonjë dokument tjetër që rregullon punët e asaj shoqërie; ose
- (b) në rastin e një ortakërie, duke qenë mbajtës i të paktën tridhjetë për qind (30%) të kapitalit të asaj ortakërie, ose që ka të drejtë të kontrollojë përbërjen ose votat e shumicës së drejtuesve të asaj ortakërie në bazë të çdo kompetence të dhënë nga marrëveshja e partneritetit ose ndonjë dokument tjetër që rregullon punët e asaj ortakërie,
- dhe **“i kontrolluar”** ose **“kontrollon”** do të interpretohet në përputhje me rrethanat. Për këto qëllime, “personat që veprojnë së bashku”, në lidhje me një person, janë personat që bashkëpunojnë në mënyrë aktive, në bazë të një marrëveshjeje ose mirëkuptimi (qoftë zyrtare apo jozyrtare) me synimin për të marrë, mbajtur ose konsoliduar Kontrollin e atij personi.

“Barrë”

është, çdo hipotekë, barrë, peng, opSION, kufizim, e drejtë refuzimi, e drejtë parablerje, ose interes ose barrë tjetër apo e drejtë interesi e çdo lloji, ose çdo marrëveshje tjetër që ka të njëjtin efekt përfshirë çdo gjë të ngjashme me sa më sipër sipas ligjeve të çdo juridiksioni.

“Asambleja e Përgjithshme” është asambleja e përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

“Qendra Kombëtare e Biznesit”

është Qendra Kombëtare e Biznesit, institucion publik shqiptar, i themeluar me ligjin Nr. 131, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, dhe që funksionon në përputhje me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.

“Ortakët”

1. **NOVUS SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me numër unik identifikimi 810818586 dhe seli në adresën Rr. “Tirana”, 31, kati 6, Prishtinë, Kosovë.
 2. **Leonora Mehmetaj Hajdini**, shtetase e Kosovës, lindur më 07.01.1981, në Trubuhoc (Kosovë), mbajtëse e pasaportës kosovare me nr. P01369875 dhe me nr. Personal 1002588664.
 3. **Genc Jakupi**, shtetas i Kosovës, lindur më 02.01.1984, në Skivjan (Kosovë), mbajtës i pasaportës kosovare me nr. P01167012 dhe me nr. Personal 1001254991.
 4. **Trëndelina Qerimi Selmani**, shtetase e Kosovës, lindur më 09.02.1986, në Gjilan (Kosovë), mbajtëse e pasaportës kosovare me nr. P00704384 dhe me nr. Personal 1170994180,
- ose në të ardhmen, çdo person fizik dhe/ose juridik pronar i kuotave në Shoqëri dhe **“Ortak”** do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

Neni 2 – Emri dhe Forma

- 2.1. Emri i Shoqërisë është **NOVUS ALBANIA SHPK**.
- 2.2. Shoqëria themelohet nga Ortakët në datën e këtij Statuti, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe është organizuar dhe funksionon në përputhje me këtë Statut, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të ligjit shqiptar. Personaliteti juridik i Shoqërisë fillon nga regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2.3. Në të gjithë dokumentat, faturat, reklammat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjeteve të përdorura për trasmetim, emri i Shoqërisë do të përbëhet nga këto elementë:
 - i. fjalët “*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*” ose “*SHPK*”;
 - ii. numri unik i identifikimit (NUIS);
 - iii. kapitali i regjistruar dhe i paguar i Shoqërisë;
 - iv. adresa e selisë; dhe
 - v. njoftimi që shoqëria është në proces likuidimi, nëse është e aplikueshme.

Neni 3 – Selia / Adresa e regjistruar e Shoqërisë

- 3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 5, Hyrja 2, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2. Administratori zotëron të drejtën për të çelur ose mbyllur adresa sekondare të Shoqërisë në Shqipëri.

Neni 4 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 4.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 5 – Objekti i Veprimtarisë

- 5.1. Aktivitetet që do të kryejë Shoqëria përfshijnë, por nuk kufizohen në, aktivitetet e teknologjisë informative si më poshtë:
 - publikimin e softuerit,
 - disenjim softueri (përfshirë analizën e kërkesave të sistemit softuer, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit softuer);
 - shitjen e pajisjeve teknologjike,
 - aktivitete shërbyese kompjuterike (përfshirë zhvillimin, mirëmbajtjen dhe testimin e sistemeve softuer),
 - përpunimi i të dhënave,
 - hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to.
- 5.2. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu konsulencë dhe shërbime, brenda kuadrit të njohurive teknike brenda kompetencës së saj, dhe veçanërisht në fushën e teknologjisë së informacionit.
- 5.3. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo biznes ose aktivitet tjetër në lidhje me ndonjë nga objektet e mësipërme ose të llogaritur drejtpërdrejt ose tërthorazi për të rritur vlerën ose për ta bërë më fitimprurës secilën veprimtari tregtare, pronë ose të drejtat e Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe në përgjithësi të bëjë të gjitha gjërat e tjera që mund t'i duket Shoqërisë si të përshtatshme ose të favorshme për arritjen e objektivave të mësipërm ose ndonjë prej tyre.

KREU II
KAPITALI; KUOTAT DHE NDRYSHIMI I TË DREJTAVE

Neni 6 – Kontributet

- 6.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë do të jetë 1,000 (një mijë) euro, e konvertuar në LEK sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, dhe përbëhet nga 4 (katër) kuota (referuar veçmas si “**Kuota**” ose bashkërisht si “**Kuotat**”). Kapitali do të paguhet nga Ortakët gjatë vitit të parë të ekzistencës së Shoqërisë (pra, nga regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit) në një ose më tepër këste.
- 6.2. Struktura e Ortakëve të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortakët	Nr. i Kuotave	Përqindja në Kapital	Kontributi Monetar (euro), i cili do të konvertohet në Lek
Novus SH.P.K.	1	70%	700
Leonora Mehmetaj Hajdini	1	20%	200
Genc Jakupi	1	5%	50
Trëndelina Qerimi Selmani	1	5%	50

Neni 7 – Transferimi i Kuotave/Kufizimet në transferim

- 7.1. Asnjë nga Ortakët Leonora Mehmetaj Hajdini, Genc Jakupi dhe Trëndelina Qerimi Selmani (“**Ortakët e Pakicës**”), nuk do të kryejnë ndonjë veprim ose do të bien dakord të kryejnë veprime mbi transferimin ose tjetërsimin e Kuotës së tij (qoftë nëpërmjet shitjes, dhurimit etj.) ose krijimin e ndonjë Barre mbi Kuotat pa pëlqimin paraprak me shkrim të Ortakut Novus SH.P.K. i cili mund ta ushtrojë këtë të drejtë në mënyrë diskrecionare.
- 7.2. Ortakët e Pakicës i njohin gjithashtu Ortakut NOVUS SH.P.K. të drejtën ekskluzive dhe diskrecionare të opsionit për blerjen e Kuotës së zotëruar nga secili prej tyre në Shoqëri (“**E Drejta e Blerjes**”) kundrejt vlerës nominale të (secilës) Kuotë. E Drejta e Blerjes e përcaktuar më sipër lind në momentin e zgjidhjes së kontratës së punës të Ortakëve të Pakicës pranë Ortakut NOVUS SH.P.K. për shkaqe të justifikuara ose me paraqitjen e kërkesës së tyre për dorëheqje.
- 7.3. Në momentin e përfundimit të marrëdhënjes së punës së cilido nga Ortakët e Pakicës tek Ortaku Novus SH.P.K., ky i fundit sigurohet që të lëshoj Vendimin e Përfundimit e Marrëdhënjes së Punës dhe të dorëzoj ofertën lidhur me ushtrimin e Drejtës së Blerjes. Brenda 30 ditëve Ortaku i Pakicës në largim dhe Ortaku Novus SH.P.K. do të nëshkruajnë të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me transferimin e Kuotës(ave).
- 7.4. Në rast se Ortaku Novus SH.P.K. vendos të shesë interesat pronësore të tij në Shoqëri tek cilado palë e tretë, i njëjti ka të drejtë që të detyrojë dhe Ortakët e Pakicës të bëjnë shitjen e tërë interesit pronësor të tyre në Shoqëri tek ajo palë e tretë e identifikuar nga Ortaku Novus SH.P.K. Ushtrimi i të drejtës së ortakut Novus Sh.P.K. për të detyruar Ortakët e Pakicës do të bëhet përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim nga ana e Novus Sh.P.K. në lidhje me kushtet e Shitjes së Kuotave të Shoqërisë. Kushtet e shitblerjes së Kuotave të Ortakëve të Pakicës nuk do të jenë më të disfavorshme në krahasim me kushtet e

shitjes së Kuotave të Ortakut Novus Sh.P.K.

- 7.5. Ortakët e Pakicës dhe Ortaku Novus SH.P.K. do të nënshkruajnë një marrëveshje ortakësh, në të cilën do të rregullohen kushtet dhe afatet, procedurat, dhe penalitetet e dakordësuara midis Ortakëve për ushtrimin e të drejtave sipas nenit 7.
- 7.6. Të drejtat dhe detyrimet sipas këtij neni, sipas rastit, do t'i transferohen automatikisht, çdo personi fizik dhe/ose juridik i cili në të ardhmen do të bëhet pronar i Kuotave në Shoqëri i cili konsiderohet se është i njohur dhe i pranon ato pa asnjë rezervë me përfitimin e të drejtave ose të cilësisë së ortakut në Shoqëri. Megjithatë, Ortaku Novus SH.P.K. (ose çdo person që trashëgon ose përfiton të drejtat e ortakut të shumicës nga ky i fundit) mund të kërkojë nënshkrimin e çdo dokumenti të nevojshëm nga ortakët e rinj (duke përfshirë ndryshimin e marrëveshjes së ortakëve) për të mbrojtur të drejtat e tij sipas këtij neni.

Neni 8 – Zmadhimi i kapitalit

- 8.1. Kapitali mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në të gjitha format dhe sipas dispozitave dhe kushteve të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe/ose vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2. Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në rritjen e kapitalit, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Rritjet në kapitalin e Shoqërisë mund të kryhen gjithashtu nëpërmjet ofertës për nënshkrimin e kuotave të reja tek një palë e tretë.
- 8.3. Kontributet e Ortakëve mund të konsistojnë në të gjitha format e aseteve të lejuara nga ligji, duke përfshirë kontributin në natyrë.
- 8.4. Huaja e Ortakëve mund të jetë me ose pa interes, madje edhe subjekt i një detyrimi rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit

- 9.1. Kapitali mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas dispozitave dhe kushteve të ligjit për shoqëritë tregtare dhe/ose vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU III **STRUKTURA E SHOQËRISË**

Neni 10 - Struktura e shoqërisë

- 10.1. Shoqëria ka këto organe shoqërie:

- a. Asambleja e Përgjithshme;
- b. Administratori(ët).

Neni 11 - Asambleja e Përgjithshme

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë dhe ka të drejtë të marrë vendime për të

gjitha çështjet e Shoqërisë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë vlefshmërinë e çdo vendimi të Administratorit/ëve, dhe nëse është e nevojshme, t'i anulojë ato në rast papajtueshmërie me Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

11.2. Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a. ndryshimet në statut;
- b. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- c. vendos për një bashkim, ndarje, shpërbërje dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- d. vendos për të çelur dhe/ose mbyllur degë dhe zyra përfaqësimi jashtë territorit të Shqipërisë;
- e. nënshkrimi dhe blerja e kuotave/aksioneve në shoqëri të tjera ose transferimi ose krijimi i ndonjë barre mbi çdo kuotë/aksion të zotëruar nga Shoqëria në çdo subjekt tjetër;
- f. mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori(ët) dhe ose çdo organ tjetër i Shoqërisë;
- g. miraton pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin dhe dokumentet shoqëruese, planin e biznesit, nëse ka, dhe shpërndarjen e fitimit dhe/ose mbulimin e humbjeve;
- h. emëron dhe shkarkon Administratorin(ët);
- i. vendos për rregullat e brendshme të menaxhimit;
- j. paraqet padi kundër administratorit(ve) të Shoqërisë;
- k. vendos për shitjen dhe ngarkimin me barrë të aktiveve që tejkalojnë pesë për qind të vlerës së aseteve të Shoqërisë që rezultojnë nga pasqyrat e fundit financiare;
- l. përcakton shpërblimin e administratorit(ve) dhe audituesve, nëse ka;
- m. vendos për emërimin e audituesve, nëse kërkohet;

11.3. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çdo çështje shtesë e cila nuk është në mënyrë të shprehur kompetencë e ndonjë organi tjetër sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij Statuti.

11.4. Nëse në çdo kohë gjatë ekzistencës së Shoqërisë, Shoqëria kalon në pronësi të një Ortaku të vetëm, të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga ky Ortak i vetëm. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen.

Neni 12 – Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

12.1. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

Administratori, ose sipas rastit, Ortakët, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, mund të thërrasin një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme në çdo kohë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se data 30 qershor të çdo viti për të diskutuar, rishikuar dhe miratuar pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë. Ortakët do të mbajnë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në atë vend që personi që thërret mbledhjen e cakton, por duke rezervuar mundësinë që çdo Ortak të marrë pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike në përputhje me nenin 12.6 më poshtë.

12.2. Njoftimi për Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Njoftimi me shkrim për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do t'i jepet çdo Ortaku të paktën 7 ditë kalendarike përpara me postë me lajmërim marrje ose email, përveç rastit kur Ortakët miratojnë me shkrim një periudhë më të shkurtër njoftimi. Një njoftim i tillë do të shoqërohet me rendin e ditës që identifikon në detaje të arsyeshme çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Me kërkesë me shkrim dërguar administratorit, secili prej Ortakëve ka të drejtë të kërkojë, nën përgjegjësinë e tij, kopjet e çdo dokumenti përkatës që do të diskutohet në mbledhje.

12.3. Kuorumi në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Kuorumi për veprimtarinë tregtare të biznesit në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme (duke përfshirë Mbledhjen e Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme) do të jetë më shumë se 30% e Kuotave për vendimet që kërkojnë shumicë të thjeshtë (50% + 1) dhe më shumë se 50% të Kuotave për vendimet që kërkojnë shumicë të cilësuar (75%) në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Nëse kuorumi nuk plotësohet brenda 60 minutave nga koha kur mbledhja duhet të kishte filluar ose nëse gjatë mbledhjes nuk përmbushet më kuorumi i nevojshëm, mbledhja do të shtyhet dhe do të mblidhet përsëri në të njëjtën kohë dhe vend në Ditën e Punës që përkon me (5) Ditë Pune menjëherë pas datës së propozuar të mbledhjes, përveç nëse të gjithë Ortakët bien dakord me shkrim për një datë tjetër (“**Mbledhja e Shtyrë e Asamblesë së Përgjithshme**”). Njoftimi për Mbledhjen e Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme do t’u jepet të gjithë Ortakëve që mungojnë, përveç rasteve kur ai është përfshirë në njoftimin fillestar të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

12.4. Procesi i votimit në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- a. Kryetari i mbledhjes do të emërohet nga Ortakët pjesëmarrës me shumicë të thjeshtë. Sekretari i mbledhjes do të emërohet nga Kryetari dhe mund të jetë edhe një noter.
- b. Sipas nenit 12.3, çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme miratohet me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1), me përjashtim të vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare (75% të votave të Ortakëve të pranishëm në mbledhje) d.m.th ndryshimi i Statutit, shpërndarja e fitimeve, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ristrukturimi dhe shpërbërja e Shoqërisë. Një shumicë e thjeshtë ose shumicë e cilësuar, sipas rastit, do të përcaktohet në përputhje me të drejtat e votës që i bashkëngjiten kuotave të Ortakëve që marrin pjesë në mbledhje.

12.5. Procesverbali i Mbledhjes

- a. Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes. Ekstraktet e vendimeve të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshme të nevojshme për depozitim sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare përgatiten nga kryetari dhe, nëse është e nevojshme, nënshkruhen nga të gjithë Ortakët e pranishëm dhe që votojnë në mbledhje. Vota kundër dhe nënshkrimi i Ortakut që voton kundër do të pasqyrohet në procesverbal dhe ekstrakte të vendimeve, por në rast se një Ortak refuzon të nënshkruajë brenda dy (2) Ditëve Pune nga marrja e ekstraktit, ky refuzim do të shënohet në mënyrë të rregullt nga kryetari i mbledhjes pranë emrit të Ortakut dhe ekstrakti do të konsiderohet si ekstrakt i vërtetë i vendimeve të marra në mbledhje vetëm me nënshkrimin e kryetarit dhe kundër nënshkrimit të sekretarit të mbledhjes.
- b. Ortaku që refuzon të kryejë ndonjë nga veprimet procedurale të përcaktuara në këtë Statut, pa paragjykuar të drejtën e tij për të votuar kundër çdo vendimit të propozuar, është përgjegjës kundrejt Ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, sipas rastit, dhe do të kompensojë çdo dëm të shkaktuar nga sjellja e tij konsiderohet me keqbesim. Për të shmangur çdo dyshim, Ortaku konsiderohet në shkelje të këtyre neneve nëse ai refuzon të nënshkruajë zyrtarisht ekstraktin e vendimeve, për sa kohë që vota kundër e Ortakut është regjistruar saktë në ekstraktin e vendimeve.

12.6. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Një Ortak mund të marrë pjesë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme me anë të telefonit, video konferencës ose formës së ngjashme të pajisjeve të komunikimit që u mundëson të gjithë Ortakëve

pjesëmarrës në mbledhje të dëgjojnë dhe flasin me njëri-tjetrin gjatë mbledhjes. Një person që merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet të jetë i pranishëm personalisht në mbledhje dhe numërohet në kuorum dhe ka të drejtë vote.

12.7. Vendimet me shkrim të Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë me vendim me shkrim pa thirrur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, me kusht që të gjithë Ortakët të votojnë pro një vendimi të tillë. Njoftimi i një vendimi me shkrim të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme duhet t'i jepet me shkrim çdo Ortaku. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e këtij Statuti, një vendim me shkrim e Asamblesë së Përgjithshme miratohet kur secili prej Ortakëve ka votuar pro një rezolute të tillë dhe ka nënshkruar një ose më shumë kopje të saj. Pasi të jetë miratuar një vendim me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme, ai do të trajtohet sikur të jetë një vendim i marrë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 13 – Administratori

- 13.1. Shoqëria do të ketë një ose më shumë Administratorë, i cili do të ketë kompetenca për të drejtuar aktivitetet e përditshme të Shoqërisë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Statutin.
- 13.2. Administratorët, nëse emërohen më shumë se një, do të veprojnë individualisht dhe do ta përfaqësojnë Shoqërinë përpara palëve të treta, përveç nëse Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe me vendim herë pas here. Çdo administrator mund t'i delegojë me autorizim/prokurë çdo kompetencë e tij Administratorit(ëve) tjetër ose ndonjë pale të tretë.
- 13.3. Administratori është i detyruar të mbajë konfidencial informacionin e Shoqërisë që ka marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tij dhe t'i kryejë detyrat e saj në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Kur një administrator, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, në kundërshtim me ligjin për shoqëritë tregtare ose me këtë statut, i shkakton shoqërisë një dëm material ose moral, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar.
- 13.4. Pavarësisht për çka është përcaktuar në këtë Statut, kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të çdo Administratori, dhe çdo kufizim i tyre, mund të përcaktohen dhe/ose të ndryshohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar herë pas here, një ndryshim i cili nuk do të interpretohet si ndryshim i këtij Statuti.
- 13.5. Administratori emërohet për një periudhë ose një mandat jo më të gjatë se 5 (pesë) vite siç përcaktohet në vendimin për emërimin e tyre dhe shkarkimi i tij vendoset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të miratuar me shumicë të thjeshtë.
- 13.6. Sa herë që i bëhet referencë Administratorit në këtë Statut, ajo duhet të interpretohet, për aq sa është e praktikueshme, si referencë për cilindo nga Administratorët e Shoqërisë nëse janë emëruar më shumë se një.

Neni 14 – Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia

- 14.1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 13, 14, 15, 17 e 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori(ët) duhet të:

- a. kryejnë detyrat e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut apo vendimet e Asamblesë së Përgjithshme në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
 - b. ushtrojnë kompetencat që i njihen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, ky Statut ose vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këto dispozita;
 - c. vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d. parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale, interesave të Personave të Lidhur dhe ato të Shoqërisë;
 - e. ushtrojnë kujdesin e duhur të një biznesmeni të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm dhe ruajë fshehtësinë për çështjet konfidenciale;
 - f. sigurojnë çdo informacion në lidhje me Biznesin dhe informacionet ekonomike të kërkuara nga çdo Ortak brenda një kohe të arsyeshme dhe në çdo rast jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuara.
- 14.2. Administratori(ët), në kryerjen e detyrave të tyre, do të mbajnë përgjegjësi ndaj Shoqërisë për një veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektin e Shoqërisë, përveç rasteve kur, në bazë të një hetimi dhe vlerësimi të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi ka qenë në mirëbesim.
- 14.3. Në rast shkelje të detyrimeve dhe standardeve të kujdesit që referohen në këtë nen, Administratori do të ketë detyrimin për të kompensuar Shoqërinë për çdo dëm që rezulton nga shkelja. Ai/ajo do të kthejë çdo përfitim personal të marrë nga ai apo persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai/Ajo do të ketë barrën e provës për të provuar përmbushjen e detyrimeve të tij dhe standardeve të kërkuara. Kur një shkelje është kryer nga më shumë se një person, të gjithë personat në fjalë do të jenë përgjegjës solidar dhe veçmas ndaj Shoqërisë.
- 14.4. Në veçanti, por pa u kufizuar në sa më poshtë, administratorët do të jenë të detyruar të kompensojnë Shoqërinë për dëmin, nëse kryejnë në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut ose vendimet e Asamblesë së Përgjithshme veprimet e mëposhtme:
- a. kthen kontributet;
 - b. paguan interes ose dividendë;
 - c. shpërndan asetet e Shoqërisë;
 - d. lejon Shoqërinë të bëjë biznes kur, sipas gjendjes së saj financiare, parashikohet që ajo të mos jetë në gjendje të paguajë borxhet e saj;
 - e. jep kredi.
- 14.5. Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohet edhe për kërkesat sipas paragrafëve të mësipërm të këtij neni. Këto pretendime duhet të paraqiten brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes ose zbulimi i saj.

KREU IV **ÇËSHTJET FINANCIARE**

Neni 15 – Audituesi

Një auditues i jashtëm i Shoqërisë do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nëse kërkohet me ligj ose nëse vendoset nga Asambleja e Përgjithshme. Mandati i audituesit, nëse emërohet, duhet të rinovohet çdo vit.

Neni 16 – Dokumentet kontabël të Shoqërisë

- 16.1. Shoqëria do të mbajë libra dhe do të përgatisë dokumente kontabël që regjistrojnë llogaritë vjetore, pasqyrat financiare, bilancet, raportet financiare dhe çdo dokument tjetër të tillë, siç kërkohet me ligj.
- 16.2. Librat e Shoqërisë dhe pasqyrat financiare vjetore, bilancet dhe raportet financiare do të mbahen në gjuhën shqipe dhe do të shprehen në lekë (LEKË).

Neni 17 – Viti financiar

Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë financiar që përfshin periudhën kohore nga regjistrimi fillestar në Regjistrin Tregtar deri më 31 dhjetor.

KREU V **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 18 – Njoftimet

- 18.1. Një njoftim i dhënë sipas Statutit:
 - (a) do të jetë me shkrim në shqip;
 - (b) do të dërgohet në vëmendje të personit dhe në adresën ose adresën e emailit, të njoftuar sipas këtij neni (ose një adresë tjetër, email ose person që pala përkatëse mund të njoftojë palën tjetër); dhe
 - (c) do të jetë:
 - (i) dorëzuar personalisht; ose
 - (ii) dërguar me email me lajmërim marrje; ose
 - (iii) dërguar me postë të klasit të parë të parapaguar ose dërgesë të regjistruar.
- 18.2. Adresat për kryerjen e njoftimit njoftohen me email ndërmjet Ortakëve dhe Administratorit pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 18.3. Një njoftim konsiderohet se është marrë:
 - (a) nëse dorëzohet personalisht, në momentin e dorëzimit; ose
 - (b) në rastin e postës elektronike, në momentin e kthimit të lajmërim marrjes; ose
 - (c) në rastin e postës së klasit të parë me parapagesë ose dërgesës së regjistruar, 48 orë nga data e postimit; ose
 - (d) nëse konsiderohet e pranuar sipas paragrafëve të mësipërm të këtij neni por nuk është brenda orarit të punës (që do të thotë nga ora 9.00 deri në orën 17.30 nga e hëna në të premte në një ditë që nuk është Ditë Pune), në ditën e punës në vendin e marrjes.
- 18.4. Për të vërtetuar kryerjen, mjafton të vërtetohet se njoftimi është transmetuar me email në adresën e emailit të Ortakut ose, në rastin e postës, se zarfi që përmban njoftimin është adresuar dhe postuar siç duhet.

Neni 19 – Likuidimi i shoqërisë

- 19.1. Pas vendimit për prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues dhe përcakton kompetencat e tyre dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për shoqëritë tregtare.

- 19.2. Likuiduesi ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare dhe ushtron kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të shoqërisë, të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 20 – Administratori(ët) e Parë të Shoqërisë

Administratori i parë i Shoqërisë, i emëruar për një mandat 5-vjeçar, është:

1. **Z. Pleurat Halili**, lindur më 16.07.1981, në Republikën e Kosovës, me nr. pasaporte BD9916939.

Neni 21 - Dispozita përfundimtare

- 21.1. Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen për çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht me këtë statut.
- 21.2. Nëse ndonjë dispozitë e këtij Statuti është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt sipas ligjeve të Shqipërisë, ajo do të konsiderohet e veçuar nga ky Statut. Në një rast të tillë, Ortakët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zëvendësuar atë me një dispozitë të vlefshme dhe të detyrueshme, efekti i së cilës është sa më afër efektit të synuar dhe në rast se nuk arrihet marrëveshje, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 22 - Hyrja në fuqi

Ky Statut do të përgatitet në shqip, në katër kopje origjinale dhe mund të nënshkruhet në kopje të veçanta, secila prej të cilave kur nënshkruhet dhe dorëzohet është një origjinal dhe të gjitha së bashku përbëjnë të njëjtin dokument. Ai do të hyjë në fuqi dhe do të bëhet i detyrueshëm me nënshkrimin e tij, ose nëse nënshkruhet në kopje të veçanta, në datën e nënshkrimit të fundit.

Neni 23 – Heqje Dorë


- 23.1. Nuk do të ketë asnjë heqje dorë nga asnjë kusht, dispozitë ose kusht i këtij Statuti, përveç rastit kur një heqje dorë është evidentuar me shkrim dhe nënshkruhet nga pala që heq dorë.
- 23.2. Asnjë lëshim ose vonesë nga ana e ndonjë pale në ushtrimin e ndonjë të drejte, tagri ose kompetence sipas këtij Statuti nuk do të përbëjë heqje dorë prej saj, dhe asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, tagri ose kompetence të tillë nuk do të përjashtojë çdo ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimi i çdo të drejte, tagri ose kompetence tjetër. Të drejtat dhe mjetet juridike të dhëna këtu janë kumulative dhe nuk përjashtojnë asnjë të drejtë ose mjet juridik të parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Nënshkruar më 22.02.2024

NOVUS SH.P.K.

Përfaqësuar nga:

Pleurat Halili


NOVUS
sh.p.k.

Genc Jakupi



Leonora Mehmetaj Hajdini



Trëndelina Qerimi Selmani





Kursi zyrtar bid-ask

Periudha kohore	22.02.2024 - 22.02.2024
Monedha e zgjedhur	Euro (EUR)

Data	Mesatarja e çmimit në blerje (Bid)	Mesatarja e çmimit në shitje (Ask)
22.02.2024	103.39	104.14

Kapitali i Shqipërisë

Bazuar në nenin 6 të statutit dhe Aktit të themelimit, Kapitali fillestar do të jetë 1000 euro, e konvertuar në lekë në datën e AKAT të themelimit dhe statutit (22.02.2024). Kapitali fillestar i Shqipërisë do të jetë si më poshtë:

$$1000 \text{ euro} \times 103.39 = 103390 \text{ lekë}$$

Kontributi i secilit ortak 'është':

- 1-) NOUES shpk $\Rightarrow 700 \text{ euro} \times 103.39 = 72373 \text{ lekë}$
- 2-) Deonora Melmetaj tjdini $\Rightarrow 200 \text{ euro} \times 103.39 = 20678 \text{ lekë}$
- 3-) Genç Jakupi $\Rightarrow 50 \times 103.39 = 5169.5 \text{ lekë}$
- 4-) Trëndelina Qentini Selmani $\Rightarrow 50 \times 103.39 = 5169.5 \text{ lekë}$

për shqipërisë

ERMAT JUREMIA